

AMF dhe “Albanian University” bashkëpunojnë për rritjen e edukimit financiar tek studentët

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për janar 2018

Zhvillime të tjera

- Drejtues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare takohen me përfaqësues të Bankës Qendrore Evropiane
- Mbi mbledhjen e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar
- Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS) zhvillon mbledhjen e Komitetit Teknik dhe Seminarin Ndërkombëtar
- Mbi përdorimin e monedhës kombëtare në tregjet financiare nën mbikëqyrje
- AMF mbi shitjen e policave të sigurimit MTPL
- AMF miraton Fondin e Kompensimit për vitin 2018, rrugëzgjdhje pagesave të mbartura ndër vite

Edukimi i Konsumatorit

- Sigurimet dhe Pensionet nga një perspektivë e re: Një ndryshim i rëndësishëm

Lajme Ndërkombëtare

- Bullgari
- Greqi
- Kosovë
- Poloni
- Rumani
- Sllovaki
- Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

AMF dhe “Albanian University” bashkëpunojnë për rritjen e edukimit financiar tek studentët

“Ne jemi të ndërgjegjshëm se tregjet financiare janë një fushë relativisht e re në shoqërinë shqiptare, madje edhe vetë institucioni, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për një pjesë prej jush është pak i njohur.”



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe Rektorja e “Albanian University”, Prof. Dr. Vera Ostreni, gjatë nënshkrimit të marrëveshjes

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi në datë 19 shkurt, një takim informues me studentët e “Albanian University” në kuadër të strategjisë për “Rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet financiare nën mbikëqyrje”. Aktiviteti synoi rritjen e njohurive dhe edukimin financiar të të rinjve për Autoritetin. Gjatë aktivitetit u nënshkrua edhe një marrëveshje bashkëpunimi mes Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe “Albanian University”, nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe Rektorja e “Albanian University”, Prof. Dr. Vera Ostreni.

Në fillim të fjalës së rastit, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi, pasi shprehu kënaqësinë për bashkëpunimin me “Albanian University” foli për rëndësinë e rritjes së edukimit financiar dhe fushatën e ndër-marrë nga Autoriteti për këtë qëllim.

“Ne jemi të ndërgjegjshëm se tregjet financiare janë një fushë relativisht e re në shoqërinë shqiptare, madje edhe vetë institucioni, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për një pjesë prej jush është pak i njohur. Prandaj edukimi financiar dhe mbrojtja e konsumatorit janë vendosur në fokus të punës sonë. Kjo, pasi eksperiencia ka treguar se një qytetar me edukim financiar të ulët është shumë herë më i rrezikuar për t’u përballur me risqe të ndryshme, të cilat nuk i ka kuptuar, duke rënë pastaj pre e abuzimeve që mund të shkaktojnë edhe dëm të madh financiar për të,” theksoi Z. Koçi.

Ai i bëri një ftesë të gjithë studentëve dhe pedagogëve të jenë pjesëmarrës aktivë përmes punimeve të tyre shkencore në konferencën e parë kombëtare që organizon Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në muajin maj në lidhje me problemet dhe sfidat për zhvillimin e tregjeve nën mbikëqyrje dhe rëndësinë e edukimit financiar.

Nga ana e saj, rektorja Ostreni shprehu bindjen se marrëveshja e nënshkruar mes dy institucioneve nuk do të mbetet thjesht në letër, por do të shërbejë për vendosjen e urave të bashkëpunimit dhe për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, si rritja e njohurive financiare në njërin anë dhe përgatitja sa më e mirë profesionale e studentëve në anën tjetër.

VËSHTRIM MBI TREGJET


Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për janar 2018

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për janar 2018 kapën vlerën mbi 1,257 milionë lekë, ose 1.59% më pak se në janar 2017. Gjatë janarit 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 88,566 me një rritje prej 6.54%, krahasuar me janar 2017. Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.62% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 7.02% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.35%.

Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 38.92% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zunë 61.08% të totalit të tregut.

Gjatë janarit 2018, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 317 milionë lekë, ose 9.76% më shumë se në janar 2017.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar 2018



Gjatë janarit 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 88,566 me një rritje prej 6.54%, krahasuar me janar 2017. Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.62% të vëllimit të përgjithshëm të primeve.

ZHVILLIME TË TJERA

Drejtues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare takohen me përfaqësues të Bankës Qendrore Evropiane

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Koçi, në datë 9 shkurt 2018 u takua me përfaqësues të Bankës Qendrore Evropiane, BQE. Qëllimi i vizitës së përfaqësuesve të BQE-së ishte vlerësimi i Programit të Reformës Ekonomike të ndërmarrë nga Shqipëria, i cili është një proces që BQE e bën në mënyrë periodike me të gjitha vendet candidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Koçi, në datë 9 shkurt 2018 u takua me përfaqësues të Bankës Qendrore Evropiane, BQE.



Drejtues të lartë të AMF-së dhe përfaqësues të Bankës Qendrore Evropiane gjatë takimit

Përfaqësues të Bankës Qendrore Evropiane ishin Z. Bernd Schnatz, Zv. Drejtor i Divizionit të Zhvillimeve të Jashtme dhe Znj. Isabella Moder. Gjatë takimit, Z. Koçi bëri një prezantim të aktivitetit të AMF-së dhe sfidat e tregjeve financiare jobankare. Nëndrejtoresha Ekzekutive Znj. Mimoza Kaçi dhe Drejtues të Departamenteve të AMF-së bënë një përshkrim të zhvillimeve të tregjeve nën mbikëqyrje, duke evidentuar zhvillimet e tregut të kapitalit, ecurinë e tregut të sigurimeve dhe fondeve të pensioneve.

Gjithashtu u prezantuan edhe zhvillimet kryesore në drejtim të plotësimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullativ, zbatimin e direktivave të Bashkimit Evropian për tregjet financiare jobankare, punën e bërë në evidentimin e risqeve të sistemit financiar, mbikëqyrjen me bazë risku, si dhe iniciativat e reja në tregun e kapitalit.

Drejtuesit e departamenteve të AMF-së prezantuan për përfaqësuesit e Bankës Qendrore edhe veprimtarinë e AMF-së në kuadër të memorandumit të përbashkët për rritjen e përdorimit të monedhës kombëtare në vend si edhe lidhur me rolin e AMF-së në kuadër të grupit të stabilitetit financiar.

Në përfundim të takimit Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Koçi theksoi gatishmërinë e bashkëpunimit të mëtejshëm të AMF-së me institucionet financiare ndërkombëtare në kuadër të çeljes së negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Mbi mbledhjen e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar

Në datën 21 shkurt 2018, u zhvillua mbledhja e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF). Në këtë mbledhje morën pjesë Ministri i Financave dhe Ekonomisë (MFE), Guvernatori i Bankës së Shqipërisë (BSh), Kryetari i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD) dhe përfaqësues të tjerë të këtyre institucioneve.

Programi i mbledhjes përfshinte vlerësimet e autoriteteve financiare të pranishme, mbi zhvillimet në institucionet dhe tregjet që mbikëqyrin. Në prezantimin mbi ecurinë financiare dhe vlerësimin e rreziqeve për sektorin bankar deri në fund të vitit 2017, përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë theksuan se vijoi rritja e aktivitetit bankar edhe gjatë tremujorit të fundit të vitit të kaluar, ndonëse me ritme më të ulëta, ndikuar nga rritja më e ulët e depozitave. Kreditimi i ekonomisë mbeti i moderuar, ku kontributin pozitiv vijoi ta japë kreditimi në lekë. Kredia me probleme shënoi rënie të dukshme, me gati 30.2 miliardë lekë gjatë vitit të kaluar.

Si rezultat, në fund të vitit 2017, raporti i kredive me probleme zbriti në 13.2%, kundrejt 18.3% një vit më parë. Krahas fshirjes nga bilancet e bankave të kredive të humbura (*write-off*), në rënien e kredive me probleme kontributin kryesor e dhanë faktorët e tjerë, ku përfshihen ristrukturimet, shlyerjet etj. Gjatë vitit të kaluar, sektori bankar përmirësoi ndjeshëm rezultatin financiar, ku ndikimin kryesor e dha rënia e ndjeshme e nivelit të rezervave (provigjioneve) për rrezikun e kreditit.

Gjendja e likuiditetit të sektorit bankar mbetet mjaft e mirë. Gjatë vitit të kaluar, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit u rrit me 0.2 pikë përqindje, duke shënuar 16.6% në fund të vitit. Këto zhvillime tregojnë se gjendja e sektorit bankar mbetet e qëndrueshme, me tregues të mirë të likuiditetit, të rezultatit financiar dhe të kapitalizimit.

Përfaqësuesit e BSh-së informuan gjithashtu mbi ndryshimet e pritshme rregullative, që do të sanksionojnë përdorimin vetëm të dokumentacionit zyrtar financiar të subjektit që kërkon hua, në analizën që bëjnë bankat gjatë procesit të miratimit të huasë. Të pranishmit vlerësuan se përdorimi i dokumentacionit zyrtar financiar në procesin e analizës së huasë i shërben formalizimit të ekonomisë, mbështet konkurrencën e drejtë dhe ul rrezikun në veprimtarinë e kreditimit të sektorit bankar. Ata vlerësuan se rënia e nivelit të kredive me probleme, duhet të krijojë kushte më të favorshme për një angazhim më të madh të sektorit bankar drejt veprimtarisë së kreditimit, mbështetur në kujdesin e nevojshëm përsa i takon treguesve të përqendrimit të kredisë dhe kërkesave të tjera mbikëqyrëse.

Përfaqësuesit e BSh-së informuan gjithashtu mbi paketën e masave për nxitjen e përdorimit të monedhës kombëtare në veprimtarinë e bankave, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i BSh-së në mbledhjen e datës 7 shkurt 2018.

Në datën 21 shkurt 2018, u zhvillua mbledhja e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF). Programi i mbledhjes përfshinte vlerësimet e autoriteteve financiare të pranishme, mbi zhvillimet në institucionet dhe tregjet që mbikëqyrin.

Të pranishmit, konfirmuan nevojën e këtyre masave dhe angazhimin e tyre për të vepruar në mënyrë të harmonizuar, në përputhje me përcaktimet në Memorandumin e Bashkëpunimit të datës 18 prill 2017.

Më tej, përfaqësuesit e BSh-së njohën të pranishmit mbi punën e përbashkët të MFE-së dhe të BSh-së në drejtim të ndërmarrjes së disa veprimeve përgatitore, të natyrës rregullative dhe operacionale, për të nxitur zhvillimin e transaksioneve të titujve të borxhit të qeverisë, pas emetimit të tyre, në atë që njihet zakonisht me emrin 'treg sekondar'.

Zhvillimi i këtij tregu mbetet një sfidë e rëndësishme për të gjithë operatorët që veprojnë në këtë treg, dhe është një proces që do të kërkojë kohë. Ky proces do të zhvillohet në konsultim të rregullt me Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Të pranishmit vlerësuan nevojën e këtij procesi dhe sugjeruan shkëmbimin e rregullt të informacionit rreth ecurisë së tij.

Sipas programit, mbledhja vijoi me prezantimin e përfaqësuesve të AMF-së, lidhur me vlerësimin e gjendjes së institucioneve dhe tregjeve që mbikëqyren nga ky institucion.

Për tregun e sigurimeve, duke iu referuar tremujorit të tretë të vitit të kaluar, përfaqësuesit e AMF-së evidentuan vijimin e rritjes së primeve bruto për sigurimet e jetës dhe të Jo-Jetës, si edhe të raportit dëme/prime neto për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës. Gjithashtu, rezultati financiar neto i shoqërive të sigurimit shfaq përmirësim të dukshëm.

Nga ana tjetër, AMF është angazhuar për të trajtuar disa problematika që lidhen me përmbushjen e kërkesave rregullative tek disa shoqëri sigurimi. Në tregjet e kapitaleve, aktivet neto të fondeve të investimit dhe numri i kuotave, kanë shënuar rritje gjatë vitit 2017. Investimet kryesore të fondeve të investimit, në varësi të monedhës, janë në tituj borxhi publikë dhe privatë, si edhe tituj të kapitalit të subjekteve të huaja private. Edhe fondet e pensioneve vullnetare kanë shënuar rritje të mirë të aktivitetit gjatë vitit të kaluar. Megjithatë, baza e ulët e nisjes, dikton peshën e tyre shumë të vogël në tërësinë e mjeteve të sistemit financiar.

Përfaqësuesit e AMF-së evidentuan si zhvillime të rëndësishme të tregut të kapitaleve gjatë vitit të kaluar, rritjen e interesit të subjekteve private në emetimin e titujve afatshkurtër të borxhit me ofertë private, licencimin e Bursës Shqiptare të Titujve – ALSE, shtimin e numrit të institucioneve financiare që shërbejnë si 'depozitar' për fondet e investimit dhe shtimin e atyre që shërbejnë si 'kujdestar' për titujt e emetuar nga subjektet private.

Të pranishmit vlerësuan që këto zhvillime kontribuojnë në thellimin e tregut të kapitaleve, dhe theksuan nevojën që baza ligjore dhe rregullative të kontribuojë që këto zhvillime të jenë të qëndrueshme. Në këtë drejtim, të pranishmit mbështetën sugjerimin e përfaqësuesve të AMF-së për të nisur një proces rishikimi të praktikave të bashkëpunimit mes autoriteteve për trajtimin e situatave të simuluar të stresit në sistemin financiar.

Sipas programit, mbledhja vijoi me prezantimin e përfaqësuesve të AMF-së, lidhur me vlerësimin e gjendjes së institucioneve dhe tregjeve që mbikëqyren nga ky institucion.

Në mbledhjet e GKSF-së marrin pjesë rregullisht edhe përfaqësues të ASD-së. Në këtë mbledhje, përfaqësuesit e ASD-së bënë një prezantim të ecurisë së depozitave të siguruara pranë bankave dhe pranë shoqërive të kursim-kreditit (shkk).

Gjatë vitit të kaluar, depozitat e sigureshme kanë njohur rritje si tek bankat ashtu edhe tek shkk-të. Në total, depozitat e sigureshme vijnë të mbizotërohen nga kursime të individëve dhe shfaqin një epërsi të lehtë të depozitave në valutë. Sipas afatit të maturimit, depozitat e sigureshme të individëve mbizotërohen nga depozitat me afat, ndërsa depozitat e tregtarëve dhe shoqërive tregtare janë të përqendruara tek llogaritë rrjedhëse.

Në përputhje me ecurinë e depozitave të sigureshme, edhe fondi i sigurimit të depozitave ka shënuar rritje gjatë vitit të kaluar. Burimi i financimit të fondit të sigurimit gjatë vitit të kaluar, siç parashikon ligji në situata normale, ishin pagesat e primit të sigurimit nga bankat dhe shkk-të, dhe administrimi i mjeteve financiare nga ASD.

Pas diskutimit të çështjeve të mësipërme, drejtuesit e institucioneve vlerësuan pozitivisht zhvillimet në sistemin financiar, në tregjet financiare dhe në kuadrin rregullativ përkatës, duke konfirmuar qëndrueshmërinë e sistemit financiar. Ata theksuan rëndësinë e monitorimit të zhvillimeve financiare dhe të përgatitjes së përmirësimeve të mëtejshme ligjore e rregullative, për të trajtuar problemet përkatëse dhe për të përsheptuar përafrimin me standardet më të mira në fushat respektive.

Në pjesën tjetër të mbledhjes, të pranishmit diskutuan mbi çështje të tjera me interes të përbashkët, që mund të diskutohen më hollësisht në mbledhjet e ardhshme të GKSF-së.

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS) zhvillon mbledhjen e Komitetit Teknik dhe Seminarin Ndërkombëtar

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS) zhvilloi në datat 22-23 shkurt 2018 në Dublin, Irlandë, mbledhjen e Komitetit Teknik, Komitetit Ekzekutiv të saj, si dhe një Seminar Ndërkombëtar. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si rregullatori dhe mbikëqyrësi i tregut të pensioneve private vullnetare në Shqipëri, u përfaqësua si anëtar i Komitetit Teknik të kësaj organizate duke u kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv Z. Ervin Koçi.

Bashkëpunëtore në organizimin e Seminarit Ndërkombëtar ishte dhe OECD.

Gjatë mbledhjes së Komitetit Teknik të IOPS-it që u mbajt më datën 22 shkurt 2018, u diskutua strategjia e punës së kësaj organizate për vitet në vijim. Në lidhje me këtë strategji, sekretariati i IOPS-it do të mbledhë dhe shqyrtojë paraprakisht kërkesat dhe idetë e anëtarëve të organizatës. Në këtë mbledhje gjithashtu, u diskutuan projektet që janë duke u zhvilluar si p.sh.:

- Rishikimi i parimeve të IOPS-it (propozimi për udhëzime në aplikimin e faktorëve ESG (ambientit, sociale dhe të qeverisjes) në mbikëqyrjen e investimeve dhe menaxhimit të rrezikut të fondeve të pensionit;
- Tendenca e investimeve e fondeve të pensionit në disa vende të përzgjedhura për këtë studim para dhe pas krizës;
- Përditësimi i rezultateve me të dhënat e vitit 2017 mbi tarifën që vendosin fondet e pensionit;
- Aftësia paguese e fondeve të pensionit me benefite të përcaktuara.

Në mbledhjen e Komitetit Teknik, nëpërmjet prezantimeve të rasteve studimore të rregullatorëve të pensionit të vendeve të ndryshme, u theksua gjithashtu, ndikimi i digjitalizimit të shërbimeve financiare në praktikën mbikëqyrëse.

Gjatë mbledhjes së Komitetit Teknik u theksua edhe roli i autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneve për zbatimin e praktikave më të mira të IOPS-it në mbrojtjen e konsumatorëve.

Në fund të kësaj mbledhje, Sekretariati i IOPS-it ftoi përfaqësuesit e dy prej vendeve anëtare të saj (Shqipërisë dhe Armenisë) për të bërë propozimin e tyre në lidhje me organizimin e Mbledhjes Vjetore të IOPS-it në vitin 2019.

Pas diskutimeve dhe votimit në mbledhjen e Komitetit Ekzekutiv të IOPS-it, Sekretariati i kësaj organizate, informoi përfaqësuesit e AMF-së se vendi ku do të mbahej mbledhja vjetore e IOPS-it në 2019 do të ishte Shqipëria. Në lidhje me këtë, Sekretariati i IOPS-it do të dërgojë shkresën për zyrtarizimin e këtij aprovimi.

Më datën 23 shkurt 2018 u mbajt seminari ndërkombëtar organizuar nga IOPS dhe OECD. Gjatë këtij seminari u trajtuan çështje të ndryshme të rëndësishme në lidhje me mbikëqyrjen dhe zhvillimin e tregut të pensioneve të tilla si: Reforma e përfshirjes automatike në sistemin e pensioneve të personave të punësuar; Planifikimi i të ardhurave të pensioneve; Ngritja e një sistemi pensionesh më të mirë; Diferencat në të ardhurat nga pensioni sipas grupmoshave social ekonomike.

Më datën 23 shkurt 2018 u mbajt seminari ndërkombëtar organizuar nga IOPS dhe OECD. Gjatë këtij seminari u trajtuan çështje të ndryshme të rëndësishme në lidhje me mbikëqyrjen dhe zhvillimin e tregut të pensioneve.

Mbi përdorimin e monedhës kombëtare në tregjet financiare nën mbikëqyrje

Në kuadër të memorandumit të përbashkët midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave “Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare”, AMF publikon analizën mbi përdorimin e monedhës kombëtare në tregjet financiare nën mbikëqyrje.



Bazuar në analizën e të dhënave nga tregu i sigurimeve, tregu i letrave me vlerë dhe fondeve të investimit rezulton se niveli aktual i përdorimit të monedhës Euro në tregjet nën mbikëqyrje është në nivele përgjithësisht të ulëta dhe i diktuar nga profili i veprimitarisë së institucioneve të mbikëqyrura.

Bazuar në analizën e të dhënave nga tregu i sigurimeve, tregu i letrave me vlerë dhe fondeve të investimit rezulton se niveli aktual i përdorimit të monedhës Euro në tregjet nën mbikëqyrje është në nivele përgjithësisht të ulëta dhe i diktuar nga profili i veprimitarisë së institucioneve të mbikëqyrura.

Autoriteti do të monitorojë zhvillimet në këto tregje dhe do të fokusohet në:

- Ndërgjegjësimin e emetuesve privatë të titujve për rreziqet që shoqërojnë huamarrjen në valutë, ndërkohë që të ardhurat kryesore janë në monedhën Lekë;
- Rritjen e transparencës për produktet që iu ofrohen investitorëve duke u përpjekur të qartësohen rreziqet e kursit të këmbimit.

AMF mbi shitjen e policave të sigurimit MTPL

Në funksion të mbrojtjes së konsumatorit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi inspektime pranë pikave të shitjeve të policave të sigurimit MTPL të disa shoqërive të sigurimit. Pas konstatimeve nga inspektimet, Bordi i Autoritetit vendosi t'u kërkojë shoqërive të sigurimit marrjen e disa masave për rregullimin e situatës.

Si pasojë e shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit, janë marrë masa për pezullimin e ushtrimit të veprimtarisë për një periudhë 6-mujore për një agjent në sigurime dhe katër punonjës të shoqërive të sigurimit, ndërsa i është ndaluar ushtrimi i veprimtarisë një agjenti tjetër në sigurime.

Në vendimin e Bordit theksohet se kontratat e sigurimit të detyrueshëm MTPL duhet të shiten vetëm nëpërmjet regjistrit elektronik online dhe nënshkrimi i tyre të bëhet vetëm nga ndërmjetësit në sigurime ose nga punonjës të shoqërive të sigurimit, të licencuar nga Autoriteti.

AMF i bën edhe njëherë thirrje konsumatorëve që të kontrollojnë online policën e tyre të sigurimit MTPL në faqen e internetit të Autoritetit, duke plotësuar të dhënat e kërkuara. Në rast se polica nuk gjendet, ata duhet të njoftojnë Autoritetin, ose strukturat e tjera ligjzbatuese për të mos rënë pre e abuzimeve.

Për të garantuar një mbrojtje sa më të mirë të konsumatorit, mbarëvajtjen e tregut dhe respektimin e ligjit, Autoriteti do të zhvillojë në mënyrë periodike inspektime në terren.

AMF miraton Fondin e Kompensimit për vitin 2018, rrugëzgjdhje pagesave të mbartura ndër vite

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në mbledhjen e datës 28 dhjetor 2017, mori një vendim mbi Fondin e Kompensimit për vitin 2018. Ky vendim i Bordit të Autoritetit vjen në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe i jep zgjidhje një problematike të mbartur nga viti 2001 me pagesat e prapambetura me Fondin e Kompensimit. Këto dëme i përkasin aksidenteve të shkaktuara nga makina të pasiguruara ose të paidentifikuara.

Sipas vlerësimeve masa e Fondit të Kompensimit për detyrimet e mbartura dhe që do të lindin për vitin 2018 vlerësohet rreth 1.8 miliardë lekë, e ndarë:

Si pasojë e shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit, janë marrë masa për pezullimin e ushtrimit të veprimtarisë për një periudhë 6-mujore për një agjent në sigurime dhe katër punonjës të shoqërive të sigurimit, ndërsa i është ndaluar ushtrimi i veprimtarisë një agjenti tjetër në sigurime.

Autoriteti, ashtu si në shumë vendime të marra gjatë vitit 2017, do të vazhdojë të fokusohet tek mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe e konsideron shlyerjen e detyrimeve të Fondit të Kompensimit si një ndër prioritetet kryesore të veprimtarisë së tij gjatë vitit 2018, edhe pse këto detyrime kanë filluar të mbarten prej vitit 2001.

- 1.25 miliardë lekë për ngjarjet nga viti 2001 deri 31.12.2013 ku përfshihen detyrime të papaguara, që janë në proces trajtimi apo proces gjyqësor pa vendim të formës së prerë;
- 418 milionë lekë për ngjarjet nga viti 2014 deri në 31.12.2017 ku përfshihen detyrime të papaguara, që janë në proces trajtimi apo proces gjyqësor pa vendim të formës së prerë, dhe;
- Jo më pak se 150 milionë lekë për ngjarjet që mund të ndodhin gjatë vitit 2018.

Bordi i AMF-së urdhëron Byronë Shqiptare të Sigurimit që të ndjekë procedurën e shlyerjes së menjëhershme të detyrimeve të papaguara të praktikave të dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit, për të cilat ka përfunduar procesi i trajtimit (përmbarimore, me vendim gjykate të formës së prerë dhe të miratuara, por të papaguara) në vlerën totale 923 354 758 lekë për ngjarjet e sigurimit nga data 01.01.2001 deri në 31.12.2017.

Njëkohësisht, për të mos krijuar borxh të ri, Bordi i AMF-së vendosi krijimin e Fondit të Kompensimit për vitin 2018, minimalisht në masën 895 203 094 lekë, i ndarë:

- 745 203 094 lekë për shlyerjen e detyrimeve për ngjarjet nga 1 janar 2001 deri në 31 dhjetor 2017 (që janë në proces trajtimi apo procese gjyqësore, pa vendim të formës së prerë) dhe;
- Jo më pak se 150 milionë lekë për ngjarjet që mund të ndodhin gjatë vitit 2018.

Vendimi bën të mundur që çdo qytetar që gjatë vitit 2018 fiton një vendim të formës së prerë nga gjykatat ose i miratohet nga shoqëritë e sigurimit, do të paguhet brenda vitit 2018.

Autoriteti, ashtu si në shumë vendime të marra gjatë vitit 2017, do të vazhdojë të fokusohet tek mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe e konsideron shlyerjen e detyrimeve të Fondit të Kompensimit si një ndër prioritetet kryesore të veprimtarisë së tij gjatë vitit 2018, edhe pse këto detyrime kanë filluar të mbarten prej vitit 2001.

Sigurimet dhe Pensionet nga një perspektivë e re: Një ndryshim irëndësishëm

(vijon nga numri i kaluar)

Gabriel Bernardino

Kryetar Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale,
EIOPA Konferenca e 7-të vjetore e EIOPA-s
Frankfurt, 22 nëntor 2017

Programi i konferencës së këtij viti iu dedikua temës “Sigurimet dhe pensionet nga një perspektivë e re”. Duke pasqyruar zhvillimet e kohës, z. Gabriel Bernardino, Kryetar i Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale në fjalën e hapjes theksoi se “...jetojmë në epokën e “inteligjencës artificiale” ku shkenca kompjuterike zhvillon “agjentë inteligjentë”, që do të thotë se kemi pajisje që e perceptojnë mjedisin e saj dhe ndërmarrin veprime që maksimizojnë shanset e saj për sukses për disa qëllime. Pra, si qenie njerëzore, duhet të jemi të aftë të “rifreskojmë” idetë tona, të “rishikojmë” rrugën tonë dhe të perceptojmë mjedisin tonë në mënyrë që të ndërmarrim veprime që maksimizojnë mundësinë tonë për ndërtimin e një tregu të suksesshëm sigurimesh dhe pensionesh për të mirën e shoqërisë sonë dhe qytetarëve tanë”.

Në fjalën e tij z. Gabriel Bernardino preku katër tema që përfshijnë prioritetet kryesore strategjike të EIOPA-s.

(Marrë me shkurtime e redaktime – pjesa e tretë)

Fuqizimi i mbrojtjes së konsumatorit në një epokë dixhitale

Zhvillimi i reformave të biznesit të sjella nga Direktiva e Shpërndarjes së Sigurimeve (IDD) dhe Rregullorja e PRIIP-it do të zbatohen së shpejti. Njohja e vështirësive për të përparuar në një fushë shumë delikate është një arritje e rëndësishme në promovimin e mëtejshëm të një qasjeje të qëndrueshme ndaj mbrojtjes së konsumatorit në të gjithë Evropën.

Mbikëqyrja dhe zbatimi i kërkesave të IDD-së është thelbësor për të siguruar arritjen e rritjes së parashikuar në mbrojtjen e konsumatorëve. Shpërndarja e sigurimeve ka nuanca të ndryshme, në shtete të ndryshme, anëtare me modele të ndryshme, që varen në një masë të ndryshme nga agjentët, brokerat dhe ndërmjetësit e tjerë, si bankat. Gjithashtu, ekzistojnë qasje të ndryshme mbikëqyrëse dhe ndryshime në atë që përbën një përzierje të përshtatshme dhe proporcionale të veprimtarive jashtë vendit dhe në vend.

EIOPA do të jetë veçanërisht e interesuar të kuptojë se si në praktikë, Autoritetet Kompetente të ndryshme Kombëtare (NCA-të) synojnë të mbikëqyrin dhe zbatojnë kërkesat e IDD-së, përkatësisht mbikëqyrjen e produktit, qeverisjen dhe rregullat e konfliktit të interesit. Kjo, e kombinuar me zbatimin e Rregullores së PRIIP, do të kërkojë që NCA-të të realizojnë aktivitete efektive për monitorimin e tregut për të zhvilluar një perceptim të thellë të produkteve të shitura dhe për të pasur akses në praktikat përkatëse të shitjes. Një tregues për kryerjen e praktikave mbikëqyrëse të biznesit duhet të dalë në tregun e brendshëm.

EIOPA do të jetë veçanërisht e interesuar të kuptojë se si në praktikë, Autoritetet Kompetente të ndryshme Kombëtare (NCA-të) synojnë të mbikëqyrin dhe zbatojnë kërkesat e IDD-së, përkatësisht mbikëqyrjen e produktit, qeverisjen dhe rregullat e konfliktit të interesit.

—○○○—
EIOPA ruan një
perspektivë progresive
drejt rregullimit dhe
mbikëqyrjes që synon
identifikimin e hershëm të
tendencave të
rëndësishme që mund të
ndikojnë në treg dhe tek
konsumatorët.

EIOPA ruan një perspektivë progresive drejt rregullimit dhe mbikëqyrjes që synon identifikimin e hershëm të tendencave të rëndësishme që mund të ndikojnë në treg dhe tek konsumatorët. Në këtë kuadër, përdorimi gjithnjë në rritje i teknologjive të reja, dixhitalizimi, të dhënat e mëdha dhe aplikacioni i inteligjencës artificiale (*machine learning*) kanë potencial të ndryshojnë ndjeshëm zinxhirin e vlerave të sigurimeve, duke krijuar mundësi të reja për të përmirësuar përvojën e klientit dhe për të gjeneruar kosto më të ulëta, por gjithashtu duke sjellë risqe të reja.

EIOPA merr një qasje strategjike ndaj platformës Insurtech dhe, për vitin 2018, tre prioritetet tona kryesore do të jenë: përdorimi i të dhënave të mëdha nga siguruesit, ku do të zhvillojmë një shqyrtim tematik të BE-së; hartëzimi i qasjeve mbikëqyrëse për inovacionin, ku do të mësojmë rreth “sandbox”-it dhe qendrave të inovacionit të vendosura në shtete të ndryshme anëtare dhe së fundi rreziku kibernetik, si nga këndvështrimi i sigurisë kibernetike të siguruesve, ashtu dhe nga sektori i sigurimeve si një sigures i rrezikut kibernetik.

Ne besojmë se rregullimi i sigurimeve duhet të jetë neutrale ndaj teknologjisë, por në të njëjtën kohë nuk duhet të krijojë pengesa artificiale që do të pengojnë inovacionin dhe do të kufizojnë potencialin për të krijuar produkte dhe shërbime më të mira për konsumatorët. Gjithashtu, nëse dëshirojmë të kemi rritje të ndërmarrjeve të reja dhe rritje në tregun e brendshëm, duhet të jemi të vëmendshëm ndaj përhapjes së mundshme të qasjeve shumë të ndryshme kombëtare ndaj inovacionit.

Duke ecur përpara, më lejoni të përmend disa pyetje që duhet ta meritojnë vëmendjen dhe debatin tonë të ardhshëm:

- A ka nevojë që të mbështesim një rregullore të bazuar në aktivitete për të siguruar që të gjithë llojet e lojtarëve, qofshin mbartës të riskut apo ndërmjetësues, kapen nga kuadri rregullator dhe se kërkesat për ofrimin e informacionit për konsumatorët janë neutralë teknologjike?
- A është koha që të fillojmë të shqetësohemi për çështjet etike që lidhen me përdorimin e algoritmeve të sofistikuar për çmimet e sigurimit?
- A nuk duhet t'i kushtojmë më shumë vëmendje daljes së burimeve të reja të mundshme të riskut sistematik, siç janë incidentet kibernetike të amplifikuara përmes ndërlidhjeve eksponenciale midis ofruesve të mëdhenj teknologjikë dhe sektorit financiar, siç është rasti i përdorimit të sigurisë së informacionit (clouds);
- A do të shndërrohet e ardhmja e sigurimit kryesisht në një instrument të orientuar drejt shërbimit, i hartuar më së shumti për të parandaluar rrezikun më shumë sesa për pagesën e dëmeve? A do të përfundojmë vetëm me një numër të vogël të mbartësve të vërtetë të riskut me bilance të mëdha për të mbuluar risqet e ngjarjeve të rralla?



Ndërsa ofruesit e sigurimeve përshtaten me mjediset në ndryshim, është gjithmonë e rëndësishme të kujtojmë nevojat e konsumatorëve dhe të sigurohemi që të drejtat e tyre respektohen gjithmonë dhe nevojat e tyre gjithmonë trajtohen.



Kur një panoramë ndryshon gjithmonë, një gjë është e sigurt: Ajo që ka funksionuar në të kaluarën, nuk do të funksionojë domosdoshmërisht në të ardhmen.

Ndërsa ofruesit e sigurimeve përshtaten me mjediset në ndryshim, është gjithmonë e rëndësishme të kujtojmë nevojat e konsumatorëve dhe të sigurohemi që të drejtat e tyre respektohen gjithmonë dhe nevojat e tyre gjithmonë trajtohen. Kjo është aq e rëndësishme sot sa ishte 70 vjet më parë dhe jam i sigurt se kjo do të vazhdojë të jetë e rëndësishme edhe pas 70 vjetësh.

(vijon në numrin e ardhshëm)

Bullgari

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në Bullgari u rrit me 7.56% sipas të dhënave të 9-mujorit të vitit 2017, duke gjeneruar 1.64 miliardë BGN (leva bullgare, monedha lokale) ose 839.72 milionë euro. Sektori i sigurimeve të Jo-Jetës gjeneroi të ardhura prej 1.3 miliardë Leva, me një rritje prej 8.59%, ndërkohë që siguruesit e Jetës raportuan të ardhura në masën 338 milionë Leva, me një rritje prej 3.77%. Përsa i përket linjave të veçanta, në segmenti e Jo-Jetës dy kategoritë kryesore mbeten MTPL dhe Kasko, pasuar nga sigurimet e pronës. Të gjitha këto kategori zënë 69% të tregut.

Greqi

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të Shoqatës së Kompanive të Sigurimit në Greqi, tregu i sigurimeve e mbylli vitin 2017 me 3.78 miliardë euro të ardhura, duke shënuar një rritje të papërfillshme. Kjo edhe për shkak të rënies me 2% të segmentit të Jetës, për shkak të shifrave negative të raportuara në shitjen e policave tradicionale të Jetës. Sa i përket linjës së biznesit të Jo-Jetës, u shënuar një rritje me 2.14%. Përveç sigurimit të pronës, të gjitha linjat e tjera të Jo-Jetës shënuan rritje gjatë vitit të kaluar në Greqi.

Kosovë

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në Kosovë gjeneroi 87.4 milionë euro të ardhura gjatë vitit 2017, me një rritje prej 4.3%, sipas të dhënave të Bankës Qendrore. Gjithashtu u raportua një rritje me 19.75 e pagesës së dëmeve, në masën e 46 milionë eurove. Segmenti i Jo-Jetës është dominues, me 84.9 milionë euro të ardhura, nga të cilat 47.6 milionë nga policat MTPL, 7.1 milionë euro nga policat kufitare dhe 30.2 milionë euro nga klasat e tjera vullnetare të sigurimit. Në anën tjetër, segmenti i Jetës pësoi rënie me 3.8%, duke gjeneruar 2.5 milionë euro të ardhura vitin e kaluar. Sipas të dhënave të 15 kompanive të sigurimit që operojnë në Kosovë, shoqëritë kanë raportuar se kanë dalë me fitim 6.9 milionë euro vitin e kaluar, ndërkohë që në vitin 2016 raportuan humbje në masën 23.9 milionë euro.

Poloni

www.xprimm.com

Në 3-mujorin e tretë të vitit 2017, tregu i sigurimeve në Poloni gjeneroi 46.15 milionë PLN (Zlota polake, monedha lokale) ose 10.7 miliardë euro, me një rritje prej 13.37% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016. Sigurimi i Jetës gjeneroi 4.25 miliardë euro të ardhura, me një rritje prej 2.7%, duke zënë rreth 40% të tregut. Policat tradicionale të Jetës shënuan rënie me 4.92%, ndërsa ato të lidhura me fondet e investimit u rritën me 10.22%. Segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës u rrit me 21.68%, duke sjellë 6.46 miliardë euro të ardhura, i udhëhequr nga rritja e madhe në sigurimet MTPL dhe Kasko.

Rumani

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në Rumani vazhdoi trendin rritës edhe në 3-mujorin e tretë të vitit 2017. Sipas të dhënave të publikuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në Rumani (ASF), siguruesit gjeneruan 7.32 miliardë RON (lei rumun, monedha lokale) ose 1.61 miliardë euro, me një rritje prej 6% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2016. Të ardhurat në segmentin e Jo-Jetës ishin 1.27 miliardë euro, me një rritje 1.3%, ndërsa sigurimi i Jetës shënoi një rritje të konsiderueshme prej 30.3%, duke gjeneruar 335.8 milionë euro të ardhura.

Sllovaki

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore, tregu i sigurimeve në Sllovaki gjeneroi 1.61 miliardë euro në 9 muajt e parë të vitit 2017, me një rritje prej 7.62% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016. Fitimet e kompanive të sigurimit në Sllovaki për 3-mujorin e tretë të vitit 2017 ishin në masën 135.9 milionë euro, me një rënie prej 12.38% krahasuar me shtatorin e vitit 2016. Referuar të ardhurave, segmenti i Jetës u rrit me 9.27%, me 774.26 milionë euro, duke zënë rreth 48% të tregut, ndërkohë që sigurimi i Jo-Jetës gjeneroi të ardhura në masën 836.54 milionë euro, me një rritje prej 6.14%.

Turqi

www.xprimm.com

Në 3-mujorin e tretë të vitit 2017, siguruesit në Turqi raportuan të ardhura në masën 33.43 miliardë TRY (lira turke, monedha lokale) ose 7.96 miliardë euro, me një rritje prej 14.76%. Sigurimi i Jetës u rrit me 49.22%, duke sjellë mbi 5 miliardë Lira të ardhura, ndërsa segmenti i Jo-Jetës u rrit me 10.26%, duke gjeneruar 28.42 miliardë Lira. Vlen për t'u përmendur se përveç linjës së sigurimit motorrik, të gjitha segmentet e tjera të biznesit raportuan rritje dy-shifrore. Në rastin e policave MTPL, rënia në masën 3.63% erdhi si pasojë e aplikimit të çmimit tavan mbi primet duke nisur nga data 12 prill 2017.

Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore gjeneroi 25.78 miliardë euro të ardhura deri në shtator 2017, me një rritje vjetore 9,8%. Segmenti i Jetës ka sjellë 9.17 miliardë euro të ardhura për siguruesit, me një rritje prej 5% në krahasim me 9 muajt e parë të vitit 2016. Ndërsa pjesa tjetër prej 16.61 miliardë euro ka ardhur nga sigurimet e Jo-Jetës, që shënuan rritje me 12.61% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016. Ashtu si edhe në rastet e mëparshme, tregjet më të mëdha të sigurimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore janë: Polonia (10.7 miliardë euro), Republika Çeke (3.57 miliardë euro) dhe Hungaria (2.28 miliardë euro), që përbëjnë rreth 65% të të ardhurave totale në këtë rajon.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al